



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:264405

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05579138

A.nr.2795/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses V.K. nga fshati ..., Komuna e ..., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Mirëqenies Sociale, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës se paditur, me datë 15.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses ... nga fshati ... Komuna e ... me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi numër 2456, i datës 13.10.2021 dhe të detyrohet e paditura ti vazhdohet ndihma sociale apo lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja me padinë e datës 24.11.2021, ka kërkuar nga Gjykata që të aprovet kërkespadia e tij dhe të anulohet vendimi Nr. 2456 i datës 13.10.2021, i Ministrisë së Punë dhe Mirëqenies Sociale. Paditësja gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë së parashtruar në gjykatë me të cilën kam kërkuar që vendimi me numër 2456 i datës 13.10.2021 të anulohet për faktin se më është bërë e padrejtë për shkak se me këtë vendim më është ndërprerë ndihma sociale me arsyetimin se djali im ... jeton në Austri e që për gjykatën deklaroi se është e pavërtetë sepse djali im në kohën kur më është ndalë ndihma sociale ka qene ende pa i mbushur 18 vjeç. Kërkoj nga gjykata që këtë vendim ta anulohet dhe të detyrohet Ministria e Punës Sociale që të ma vazhdojë dhe të ma njoh të drejtën e ndihmës sociale siç e kam gëzuar edhe me herët, krejt ato që kanë thënë ministria janë të pavërteta sepse unë kam vepruar sipas kërkesave të tyre, ata kanë qenë edhe në shtëpi dhe i kanë parë; kushtet ku kam jetuar dhe asnjëherë nuk me kanë kërkuar dokumenta plotësuese, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem pranë padisë dhe deklarimeve të thëna në këtë seancë dhe kërkoj nga gjykata që të anulohet vendimi i datës 13.10.2021 me numër 2456 dhe të detyrohet e paditura që ti vazhdohet ndihma sociale apo që vendimi të anulohet dhe të kthehet lënda në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura në përgjigje në padi të datës 27.03.2023 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, ku Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndihmës Sociale Shkalla e II-të/ Departamenti për Politika Sociale dhe Familjes ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe faktet relevante dhe ka

konstatuar se familja nuk i plotëson kriteret për ndihmë sociale, sipas verifikimit nga komisioni verifikues i QPS-së, pasi që familja nuk i ka ofruar dëshmitë e kërkuara nga QPS. Lidhur me këtë aktvendimi me nr.2456 të datës 13.10.2021 është nxjerrë në pajtim me gjendjen faktike dhe juridike siç e përcakton dispozita ligjore të nenit 2 pika 2.1 pika 2.4 neni 4 pika 4.1a, neni 5 pika 5.1 të Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligjit Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 dhe neni 5 pika 3,5,6 dhe neni 10 i Udhëzimit Administrativ(MPMS) nr. 06/2013 për Përlllogaritjen e të Mirave Materiale dhe jo Materiale si dhe të Hyrave të Llogaritshme dhe jo të Llogaritshme, dhe Familja nuk përzgjidhet dhe nuk i njihet e drejta për vazhdimin e realizimit të ndihmës sociale, pasi që nuk ka ofruar dëshmi bindëse për komisionin rreth bashkësisë familjare, ashtu që kërkesa e paditëses i refuzohet dhe mbetet në fuqi aktvendimi me nr. 24722 të datës 18.06.2021 lëshuar nga QPS në ..., andaj ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadija e paditëses dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Aktvendimi me numër 2456 i datës 13.10.2021; Fletëleshimi me epikrizë lëshuar nga International Hospital me numër amz 19 i datës 08.06.2019; Epikriza nga dokumentacioni mjekësor nga spitali Amerikan i datës 25.02.2019; Dokumentacion mjekësor i lëshuar nga spitali ne Turqi KOÇ UNIVERSITETI HASTANESI PET/CT i lëshuar me datë 19.09.2019; Dokumentacioni mjekësor i lëshuar nga spitali DR NESTOROV LEKARSKA ORDINANCA BEOGRAD e datës 21.01.2019, Kartela e ndihmës sociale e datës 13.01.2020; Njoftimi i lëshuar nga e paditura departamenti ligjor e datës 20.03.2023; Përgjigja në padi nga Komuna e Pejës e datës 17.03.2023; Ankesa e parashtruar nga paditësja me numër 315 e datës 15.09.2021; Aktvendimi i datës 18.06.2021; Formular për përlllogaritjen e të mirave materiale e datës 19.04.2021; Të dhënat e anëtarëve të familjes me datë të printimit 19.04.2021; Testi i të hyrave financiare me datë të printimit 19.04.2021; Aktvendimi i datës 19.04.2021 me nume të lendes 24722; Aktvendimi i datës 18.06.2021; Dëftesa mbi parashtrimin e kërkesës për ndihmë sociale 19.04.2021; Kopja e letërnjoftimit për ...; Ekstrakti i lindjes ... me numër 2308158; Kopja e letërnjoftimit te paditëse; Estrakti i lindjes te paditëses e datës 10.04.2015 Certifikata e lindjes ... e datës 08.04.2015; Certifikata e lindjes ... 08.04.2015 Deklarata e bashkësisë familjare me numër F00518400; Dëftesë mbi parashtrimin e kërkesës për ndihmë sociale e datës 10.04.2020; Vërtetimi i tatimit në pronë; Vërtetimi mbi gjendjen ekonomike me numër 45626 te datës 03.06.2020; Vërtetimi mbi gjendjen ekonmike ne emër te ... e datës 03.06.2020; Certifikata qe nuk posedon palujtshmeri e datës 04.06.2020; Testi i të hyrave financiare e datës 10.04.2020; Ekipi verifikues i datës 10.04.2020; Vlerësimi i komisionit mjekësor ne emër te paditëses 06.05.2018; Raportet mjekësore nga QKMF Novosellë i datës 15.04.2019 tek neurologu; Raporti i datës 02.06.2020 I QKMF-së.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKAsë dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Me vendimin e kontestuar me numër 2456, të datës 13.10.2021, gjykata vërtetoi se e paditura, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses se ndihma sociale është ndërprerë familjes në mungesë të dokumentacionit të kërkuar dhe pala nuk ka sjellë për djalin ... pasi që i njëjti tani jeton dhe punon në Austri.

Me Aktvendimin nr.24722, të datës 18.06.2021, gjykata vërtetoi se paditëses i është ndërprerë pagesa e ndihmës sociale familjes së ..., me arsyetimin se paditësja nuk ka sjellë dokumentacionin e kërkuar për anëtarin e familjes.

Me ankesën e parashtruar nga paditësja të datës 15.09.2021, gjykata gjeti se paditësja me ankesë ka pranuar që dokumentacioni për djalin e saj Agonin nuk i është dorëzuar të paditurës në mungesë të dokumenteve të tij për shkak se djali i saj është adaptuar nga halla për shkak të gjendjes ekonomike të dobët, por nuk ka pas sukses tash është pajisur me letërnjoftim.

Nga formulari për përlogaritjen e të mirave materiale A3 i përpiluar nga e paditura me datë 03.06.2021, gjykata gjeti se gjatë verifikimit të gjendjes së paditëses është konstatuar se me rastin e rivlerësimit në teren familja i plotëson kriteret për kategorinë e parë. Me rasti e rivlerësimit në teren familjes i ndërpritet ndihma sociale për mungesë të dokumenteve që kemi kërkuar lejen ... por nuk e ka sjell se ...jeton në Austri ku dhe jeton.

Gjykata iu referua nenit 4 të Ligjit 2003/2015, si dhe ligjit numër 04/L-096 për Ndryshmin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/215, ku përcaktohet se “*Kriteret jo-financiare për ndihmë sociale 4.1. Për të përfituar ndihmën sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm në Kosovë dhe t'i plotësojnë kushtet për klasifikim në njërin prej kategorive vijuese: (a) Kategoria e parë Familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 pikën 7 të këtij ligji dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar. (b) Kategoria e dytë Familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe: (i) me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç apo (ii) që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç , Të gjithë anëtarët e familjes për përfshirje në kategorinë e dytë ose duhet të jenë të varur sipas përkufizimit të nenit 2.7 të këtij ligji, ose duhet të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale”.* Me UA numër 06/2013 neni 10 përcaktohet se të hyrat e përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto: 1.1. të hyrat e fituara; 1.2. të hyrat e trashëguara, dhurata; 1.3. të hyrat e pranuar në mall; 1.4. qiraja, dërgesat e parave; 1.6. pensionet e kursimeve individuale dhe pensionet plotësuese individuale ose të punëdhënësve; i .7. pensionet që merren nga jashtë; 1 8. disa pagesa të përgjithshme dhe lloje të ndryshme të të hyrave. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat paditëseja as pranë të paditurës e as pranë gjykatës nuk ka argumentuar se nuk ka të hyra nga jashtë ku është konstatuar se djali i saj ... gjendet jashtë vendit në Austri ku edhe vet me parashtrimin e ankesës ka deklaruar se djali i saj jeton të halla.

Gjykata gjeti se Vendimi përfundimtar i kontestuar nga paditëseja, është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi, përkatësisht konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Sa i përket vendimit përfundimtar të marrë nga e paditura, gjykata gjeti se e paditura ka marrë vendim në përputhje me ankesën e paditëses dhe vendimi i atakuar i përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Struktura formale e vendimit, është në përputhje të plotë me nenin 47 të LPPA-së, ashtu sikurse edhe arsyetimi i dhënë, përputhet në tërësi me nenin 48 të po të njëjtit Ligj.

Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditëseja as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ofroi prova të mjaftueshme për të mbështetur pohimet e saj të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës, i është shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar me ligj.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë aktvendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrasi arsyetimin e të paditurës të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar se familjes i ndërpritet ndihma sociale për mungesë të dokumentacionit të kërkuar dhe pala nuk ka sjellë për djalin dokumentacionin për shkak se i njëjti tani jeton dhe punon në Austri .

Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës ndaj ankesës së palës pasi që edhe vet pala paditëse në ankesë e ka pranuar se djali jeton të halla dhe tek tani ka dokumente dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera

të paditëses, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata përfundimisht konstatoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësit.

Mbi këto arsye thëniet e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u morë duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 43, 46, par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2795/2021, të datës 04.04.2024.

G j y q t a r j a

Valbona Gjonbalaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.